



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 604 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

VENDIM

Nr. 504, datë 06.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurim dhe rijetezim i banesës së z. Ramazan Kapllani M-083, lagje Mangalem”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Bashkia Berat, me aplikues Znj. Valbona Lufta dhe zhvillues **Z. Ramazan Kapllani**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren nga DRTK Berat sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

